



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i studimit me karakter profesional
“Laborant i Lartë Dentar”
i Institucionit të Arsimit të Lartë
Universiteti Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Alketa Qafmolla
2. Dr. Alba Koshovari

Tetor /2022

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për programin e studimit me karakter profesional në “Laborant i Lartë Dentar”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Stomatologjisë (Fakulteti i Shkencave Mjekësore)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program me karakter profesional në “Laborant i Lartë Dentar”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 516 prot., dt.24.10.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Akreditohet për herë të parë
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/ 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (v.a 2021- 2022)	20 PAE/ 3 PAK Shënim: 6 nga stafi PAE janë laborante
18	Numri i studentëve:	205 student
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit “Laborant i Lartë Dentar” ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University” është licencuar me UMASR nr. 516 prot, datë 24.10.2019

Programi ofrohet nga Departamenti i Stomatologjisë (Fakulteti i Shkencave Mjekësore) si një cikël studimi 2-vjeçar, 4 semestra, 120 kredite. Shkolla e Laborantëve dentare është shkolla e parë e këtij profili, e hapur qe në vitin 2002, e njohur në ato vite me emrin shkolla e Laboranteve “Ufo Dental”.

Programi i studimit me karakter profesional në “Laborant i Lartë Dentar” është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të arsimit me qëllim përgatitjen e profesionistëve të aftë për gjithë sektorët përkatës të zinxhirit shëndetësor. Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti fiton titullin “Laborant i Lartë Dentar” për Republikën e Shqipërisë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

ASCAL vuri në dispozicion të grupit të vlerësimi të jashtëm gjithë dokumentacion nga univesiteti aplikues për akreditim, ku ky grup u njoh me programin e studimit profesional në ciklin 2 vjeçar të studimit dhe hartimin e RVB, pedagogët hartues, lëndët dhe syllabuset.

Grupi, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm, vënë në dispozicion, ndërmori vizitën në institucion, ku u njoh me infrastruktuën dhe materialet laboratorike të vëna në shërbim të studentëve, u njoh me pedagogët mjekë dhe pedagogët laborante, u njoh me procedurat e rekrutimit të tyre, si dhe u sqaruan një sërë pyetjesh që grupi pati lidhur me kriteret dhe standardet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Një vëmëndje e veçantë, iu kushtua edhe takimit me studentë të vitit të parë dhe të vitit të dytë. GVJ u njoh me aktivitetet e tyre të organizuara nga institucioni, si pjesëmarrja në kongrese dhe konferenca të cilat ishin thujse të përvitshme si referues ose thjesht si pjesëmarrës. Institucioni referoi që kishte bashkëpunim të ngushtë me disa prej laboratorëve lider në Tiranë, në mënyrë që studentët të njihen dhe të praktikojnë materialet dhe teknologjinë e re në fushën e laboratorit. Në fund të vizitës dekani dhe shefi i departamentit shoqëruan GVJ në laboratorin e institucionit.

Koordinator teknik nga ASCAL në këtë vlerësim ka qenë Msc. Aviola Bardhi.

Më datë 29/09/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 24/33 Prot., datë 29/09/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimi të Jashtëm.

Universiteti kthehu përgjigje, përmes AMS, më datë 05/10/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 552 Prot., datë 05/10/2022.

IAL është shprehur se masat për përmirësimin e rekomandimeve do meren në vitin e ardhshëm akademik, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i programit të studimit me karakter profesional “Laborant i Lartë Dentar”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ referuar gjetjeve gjatë vizitës në institucion dhe RVB-së konstaton që programi i studimit 2 vjeçar në "Laborant i Lartë Dentar" ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve. Në këtë program studimi ka një ndërthurje midis njohurive teorike, laboratorike dhe aftësimi praktik të studentit duke formuar koncepte të qarta për efikasitetin e punës në grup, duke njohur konkurrencën në tregun e punës dhe duke i ndërgjegjësuar për rëndësinë dhe dobinë e produkteve të tyre. Në Rregulloren e programit të studimit në “Laborant i lartë dentar”, jep objektivat e përgjithshme dhe ato specifike për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale.</p> <p><i>(Syllabuset. Objektivat e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Aspekti juridik, misioni i AU, Standardet bashkëkohore, Autonomia Institucionale, Liria Akademike, Paprekshmëria territoriale, Organizimi dhe Drejtimi i AU janë përcaktuar shumë qartë në Statut. Për të ofruar një përgatitje dhe aftësim të plotë profesional janë përkrahur në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit karakteristikat e zhvillimit të procesit mësimor në përputhje me programin e studimit.</p> <p><i>(https://albanianuniversity.edu.al/sq/statuti/)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/ kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>AU me programin e studimit 2 vjeçar në "Laborant i Lartë Dentar" ofron studime në drejtim mjekësor, bazuar në misionin e Institucionit, rregulloren, objektivat dhe zhvillimin e kompetencave të studentëve. Strukturat përgjegjëse bashkëpunojnë ngushtë me njëra tjetrën për të plotësuar qëllimet dhe misionin e shkollës.</p> <p><i>(Statuti, rregulloret)</i></p>
<p>Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Nga vëzhgimet dhe studimet periodike të tregut të punës nga AU, propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe. Nevoja e studiuar e grupmoshave për arsim profesional të specializuar në teknika bashkëkohore të shkencës së laboratorit dentar u shfrytëzua në këtë program të ri studimi.</p> <p><i>(Takimi me studentët, takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Zyrës së mbështetjes studentore)</i></p>
<p>Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen</p>	<p>Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve. Një ndihmesë të madhe jep edhe zyra e alumni e cila u kontaktua nga grupi i</p>

Peskuako



Skur

studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.	GVJ, ku u njoh me plotësimin e pritshmërive të studentëve përsa i takon tregut të punës. (Dokumentcioni i zyrës Alumni).			
Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	Universiteti AU ka krijuar lidhje me laboratorët dentar më të njohur në Tiranë, ku studentët mund të kryejnë praktikat profesionale me teknologjinë e fundit laboratorike. Patëm referime për emrat dhe vendndodhjen e laboratorëve me pajisjet e fundit me të cilët Univeristeti ka bashkëpunim. Ekzistojnë kontrata dhe marrëveshje bashkëpunimi të AU por do të duhet të plotësohen më mirë nevojat e studentëve për praktika në një numër më të madh laboratorësh. (Takimi me studentët dhe stafin).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Universiteti AU zotëron disa struktura klinike dentare të cilat vihen në dispozicion të programit të studimit 2 Vjeçar "Laborant i Lartë Dentar". GVJ gjatë vizitës në institucion njohu nga afër këto struktura, ndërlidhjen mes laboratorit të shkollës dhe pjesës klinike. (Takimet në AU)
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, me punëdhënës vendës, aktorë të biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	Universiteti AU ka nënshkruar një sërë marrëveshje në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Këto marrëveshje bëhen në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore, për efekte të kërkimit shkencor si dhe për të ndihmuar studentët në gjetjen e një vendi pune. GVJ përveç gjetjeve në RVB lidhur me bashkëpunimin e insitucionit me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe të huaj, për edukimin në vazhdim të stafit akademik. Referuar dokumentit. (Raporti periodik nga marrëveshjet e bashkëpunimit).

<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti harton në mënyrë periodike raportin analitik në lidhje me përfitimet e marrëveshjeve kontrakte. Këto raporte janë evidentuar edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>(Tabelat RVB), (Raporti periodik nga marrëveshjet e bashkëpunimit)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Nga verifikimi i dosjes dhe vizitës në institucion rezulton se Departamenti që mbulon programin mësimor "Laborant i Lartë Dentar", ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit, bashkëpunon me kompani të ndryshme me qëllim zhvillimin dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore të programit të studimit. Duhet theksuar se institucioni ofron infrastrukturën e nevojshme për të mbuluar të gjitha praktikat mësimore që përmban plani mësimor i këtij programi studimi.</p> <p><i>(Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>GVJ u njoh nga afër me iniciativat specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve të ndërmarrja nga institucioni dhe megjithëse në vitin e dytë të programit të ri të studimit, 4 studentë, në përfundim të vitit të dytë, referuan që ishin punësuar në profesion.</p> <p><i>(Takimi me studentët, takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Zyrës së mbështetjes studentore)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi I.3 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kifikimeve për këto programe studimi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/ module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit profesional në degën Laborant i lartë Dentar është i strukturuar në 2 vite akademike, organizuar në 4 semestra me 120 ECTS. Ky program është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti, nga një student që ndjek këtë program studimi është 60 kredite. Zhvillohen gjithsej 21 lëndë me 34 modulet përkatëse të ndara sipas 2 viteve akademike. Detyrimi përmbullës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e provimit të formimit (teorik dhe praktik).</p> <p><i>(Plani mësimor AU); (Rregullore e programit të studimit).</i></p>






<p>Kriteri 2. Programet e studimeve me karakter profesional synojnë përfitim të njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit profesional në degën Laborant i Lartë Dentar si dhe gjatë takimit me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se ky program studimi u ofron studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme dhe ju përgjigjen kërkesave për realizimin e tyre profesional edhe për të ndjekur ciklet e tjera të studimit. (Plani mësimor profesional në AU; (Syllabuset)</p>			
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Lëndët e parashikuara që zhvillohen në programin e studimit profesional Laborant i Lartë Dentar janë gjithëpërfshirëse duke filluar nga ato të formimit të përgjithshëm si shkencat e sakta, gjuhë të huaj apo anatomi dhe më pas duke u thelluar përgjatë viteve në lëndë profesionale si protezë totale, protezë parcialet dhe fikse, ortodonti etj, të cilat synojnë të japin njohuritë e mjaftueshme teorike dhe praktike. (Plani mësimor Ba në TLD); (Tabelat RVB Ba në TLD, tabela nr.9)</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Bazuar në programin e studimit 2 vjeçar në "Laborant i Lartë Dentar" të ofruar, vërehet një përputhje e plotë në lidhje me veprimtaritë profesionale të cilat synojnë kompetenca profesionale për studentët si në ambjentet brenda Universitetit por edhe jashtë tij. Studentët kanë mundësi të përballen me situata të ndryshme sipas rasteve që u mundësohen për tu praktikuar. (Takimi me stafin dhe studentët)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Nga mbikëqyrja në Institucion u vërejt se strukturat përgjegjëse kanë plotësuar kërkesat ligjore në lidhje me numrin e kërkuar të stafit, kifikimin e tyre, organizimin cilësor të strukturës akademike. Numri i stafit është në raport të drejtë me numrin e studentëve. Numri i pedagogëve 20 PAE/ 3 PAK. Numri i studentëve 205. (Tabelat RVB)</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Në programin e studimit 2 vjeçar në "Laborant i Lartë Dentar" të ofruar janë përshkruar objektivat e përgjithshëm dhe specifik për çdo vit akademik. Ato tregojnë shkallën në rritje të njohurive profesionale të studentëve, fitimin e kompetencave dhe aftësive në zhvillim nga viti në vit. Ato janë të qarta dhe të realizueshme nga studentët. (Rregullorja, Syllabuset. Objektivat e programit të studimit)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit të ciklit të parë, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formues, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Albanian University bazuar në kapacitetet fizike dhe njerëzore realizon në mënyrë optimale programet e studimit që ofron, si dhe plotëson normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Programi i studimit me karakter profesional “Laborant i Lartë Dentar” synon të pajisë studentët me dijet bazë në fushën e laborantit dentar. Qëllimi kryesor i këtij programi studimi është që aplikantët të zotërojnë njohuritë teoriko-praktike për t’u formuar specialist dhe për t’u bërë në të ardhmen laborantë dentar me njohuri që ecin paralelisht me hapin e kohës. Studentët e diplomuar në këtë program studimi do të kenë mundësi të punojnë si profesionistë të lirë, pranë klinikave stomatologjike, private apo institucionale (universitare), pranë institucioneve publike në sektorë prodhues dhe promovues të pajisjeve dentare laboratorike, në qendrat kërkimore të profilit të laborantit dentar. <i>(Dokumenti “Programi me karakter profesional “Laborant i lartë dentar”)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Kurrikula ofron ndërthurje të njohurive teorike dhe praktike, duke sjellë në përmbajtje të saj të gjitha risitë në fushën specifike. Në vitin e parë janë përfshirë orë të leksioneve dhe seminareve në lëndët e formimit bazë, me qëllimin që studenti të ketë njohuri të plota në modulet e formimit mjekësor; njohuri këto që do t’i vijnë në ndihmë aplikimit praktik të lëndëve karakterizuese të programit. Zhvillimi i disa lëndëve ndërdisiplinore në këtë semestër ndihmon në parapërgatitjen e studentit, për thellim njohurish dhe ndërlidhje profesionale të lëndëve karakterizuese. Në vitin e dytë thellohen njohuritë me lëndët ndërdisiplinore, duke rritur numrin e orëve që studenti kalon në auditor në këto module, me leksione, seminare apo praktika. E rëndësishme është aplikimi i detyrave të kursit, detyrime që student i plotëson gjatë orëve mësimore, që më pas futen në detyrime me afate dorëzimi dhe vlerësimi për studentët. Studentët aftësohen në përgatitjen e protezave të lëvizshme sipas rasteve klinike të paraqitura në klinikë. Kompetencat për modelimin dhe përgatitjen e aparateve të lëvizshme ortodontike, të protezave mbi implantë, janë elemente të tjerë shtesë të njohurive dhe atësive profesionale që studentët fitojnë gjatë programit të studimit me karakter profesional “Laborant i Lartë Dentar”. Studentët fitojnë aftësinë të bashkëveprojnë me mjekun stomatolog, duke iu përgjigjur me profesionalizëm çdo etape laboratorike të kërkuar sipas plantrajtimeve dentare. Studentët aftësohen të modelojnë urat fikse dhe t’i përgatisin ato në laborator, duke përvetësuar edhe protokollin e punës në klinikën dentare. Sektorët e mundshëm për punësim të studentit, bazuar në</p>



	<p>vlërësimin e tregut të punës kryer nga Departamenti i Stomatologjisë, janë të gjerë, kjo bazuar në kapacitetin profesional formues të këtij programi studimi me karakter profesional, kohëzgjatje 2 vjeçare. (Dokumenti "Programi me karakter profesional "Laborant i lartë dentar")</p>			
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Nga vëzhgimi i dokumentacionit GVJ u konstatua një vlefshmëri e saktë në planin mësimor, ngarkesën mësimore, modulet përkatëse për çdo vit studimi, kreditet, orët në auditor, mënyrën dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve. Ato janë të dokumentuara.</p> <p>(Dokumenti i paraqitur i programit dhe planit mësimor)</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Dosja e paraqitur për GVJ mbi syllabuset e lëndëve përmbante dokumentacionin original të syllabuseve për të dyja vitet e studimit. Secili syllabus përshkruante emërtimin e lëndës dhe modulit përkatës, emrin e pedagogut, kreditet, orët në auditor, leksione, seminare, detyra kursi/ushtime, kolokiume, praktika, projekte, orë laboratorit, përmbajtja e lëndës, format e vlerësimit, literaturë përkatëse për secilën lëndë.</p> <p>(Dosja e syllabuseve për secilin vit)</p>			
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Ndërthurja e lëndëve teorike me ato praktike, aftësimi në laborator e studentëve, detyrat e kursit, aktivitetet krijuese, krijimi i lidhjeve me klinikat stomatologjike përgjatë kohës së përgatitjes profesionale kanë ndihmuar studentët në një formim cilësor duke rritur kështu dhe mundësitë për punësim.</p> <p>(Dokumenti i paraqitur i programit dhe planit mësimor) (Dosja e syllabuseve për secilin vit) (Takimi me studentët, stafin, Zyrën e Alumni)</p>			
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Lidhja teori – praktikë është çelësi i suksesit të realizimit të formimit cilësor të studentëve në programin e studimit 2 vjeçar në "Laborant i Lartë Dentar" në AU. Orët praktike zënë një vend të rëndësishëm në kurrikul. Ato bëjnë të mundur aftësimin praktik dhe fitimin e kompetencave profesionale të studentëve. Lehtësojnë vlerësimin dhe rivlerësimin nga vetë studenti.</p> <p>(Dokumenti i paraqitur i programit dhe planit mësimor) (Takimi me studentët, stafin)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.2

Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënës sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra,</p>	<p>Programi i studimit profesional në degen Laborant i larte Dentar është i strukturuar në 2 vite akademike, organizuar në 4 semestra me 120 ECTS.</p>



<p>vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ky program është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti, nga një student që ndjek këtë program studimi është 60 kredite. mërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. <i>(Dokumenti i paraqitur i programit dhe planit mësimor)</i></p>			
<p>Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Laborant i Lartë Dentar si dhe gjatë takimit me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se ky program studimi u ofron studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme dhe ju përgjigjen kërkesave për realizimin e tyre profesional edhe për të ndjekur ciklet e tjera të studimit, apo edhe për punësimin e tyre. <i>(Dokumenti i paraqitur i programit dhe planit mësimor) (Takimi me studentët, stafin)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/ lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe shqyrtimin i dokumentacionit të vënë në dispozicion të GVJ u pa që plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/ lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese por duhet të rishikohen temat e disa lëndëve profesionale, të cilat duhet të jenë të përshtatura për laborantët dentar. Gjithashtu, nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, është realizuar rishikimi i programeve të studimit, në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm, në përputhje me nevojat e diktuar nga studimi i tregut të punës, si dhe përditësimi i syllabuseve. <i>(Dokumenti i paraqitur i planit mësimor, dosja e syllabuseve)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/ punë konkrete në profesion.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Laborant i Lartë Dentar u vu re që kishte një raport të drejtë midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (1:1). Aftësimi praktik i studentëve zë rreth 1/4 e programit të përgjithshëm. <i>(Dokumenti i paraqitur i planit mësimor, dosja e syllabuseve)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Lëndët e parashikuara që zhvillohen në programin e studimit profesional në Laborant i Lartë Dentar janë gjithë përfshirëse duke filluar nga ato të formimit bazë si shkencat e sakta, gjuhë të huaj apo anatomi dhe më pas duke u thelluar përgjatë viteve në lëndë profesionale si protezë totale, proteze parciale dhe fikse, ortodonti etj, te cilat synojnë të japin njohuritë e mjaftueshme teorike dhe praktike në përshtatje me mundësi për studime post diplome apo për punësim. <i>(Dokumenti i paraqitur i planit mësimor, dosja e syllabuseve)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.3

Përmbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përmbajtjen e moduleve/ lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>GVJ mbështetur në dosjen e vetvlerësimit dhe vizitës në institucion konstaton së Departamenti Stomatologji në programin e studimit Laborant i Lartë Dentar disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Si pjesë të këtij informacioni përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregulloret e universitetit. Informacionet janë të publikuara edhe në faqen e internetit të Universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë. Kjo kurrikul ofron ndërthurje të njohurive teorike dhe praktike, duke sjellë në përmbajtje të saj të gjitha risitë në fushën specifike.</p> <p><i>(Plani mësimor, Rregullorja e programit; Syllabuset e lëndëve; CV e personelit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është akte, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>Në vitin e parë bëhen kryesisht lëndë të formimit bazë si anatomi dhe fiziologji, mikrobiogji. Në vitin e dytë merren njohuri të lidhura ngushtësisht me fushën e studimit. Programi ofron mundësi të shumta informacioni si dhe nocione bazë dhe të thelluara profesionale. Disiplinat në planin mësimor, sasia e krediteve dhe e orëve të vëna në dispozicion për secilën disiplinë, syllabuset e tyre, bëjnë të mundur që në përfundim të programit të studimit të jenë arritur objektivat formuese të këtij program studimi dhe rezultatet e të nxënit dhe aftësimit profesional.</p> <p><i>(Plani mësimor)</i> <i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjen e tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni AU në degën "Laborant i Lartë Dentar", doli në përfundimin që përmbajtja e programit të studimit parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme në të gjithë komponentët e kurrikulës së këtij programi. Përmbajtja e përgjithshme e moduleve dhe transmetimi i njohurive lehtësojnë formimin teorik dhe praktik të studentëve në funksion të punësimit të tyre.</p> <p><i>(Plani mësimor)</i> <i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfundimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>Në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga RVB dhe të vënë në dispozicion nga institucioni u vu re që modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/ punë konkrete mundësojnë përgatitjen e plotë të studentëve për një formimit profesional të përshtatshëm por edhe për një orientimin cilësor në përvojën e punës.</p> <p><i>(Syllabuset e lëndëve)</i> <i>(Takimi me studentët, pyetësi)</i></p>

<p>Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Në takimin me studentët dhe stafin u identifikua një bashkëpunim i ndërsjellë midis punëdhënësve, stafit, tutoriatit, studentëve. Studentët kishin mundësi të komunikonin me përfaqësuesit e tyre të grupeve direkt me pedagogët e tutoriatit dhe të zgjidhnin çdo problematikë në kohë reale, të shpërndanin informacionin në mënyrë unike për gjithë grupin. Nga takimi dhe raporti i NJSBC u konstatua së ky program studimi garanton formimin dhe vlerësimin cilësor të studentëve në këtë program studimi.</p> <p><i>(Takimi me studentët, stafin, pyetësi)</i> <i>(Takimi me NJSBC, Raporti)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Pejuvalla



Ilcey

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Shtyllat kryesore në të cilat mbështet Albanian University janë cilësia akademike dhe kërkimi shkencor. Universiteti ofron arsim gjithëpërfshirës të studentëve nëpërmjet një stafi akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore, me eksperiencë disa vjeçare në mësimdhënie si dhe me kifikime të vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit. Universiteti organizon në mënyrë periodike aktivitete trajnimi në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Këto aktivitete synojnë zhvillimin e stafit dhe të studenteve në përdorimin e metodave të ndryshme innovative në fushën e mësimdhënies, të përshtatura sipas natyrës së programeve të studimit. Këto udhëzues dhe aktivitete janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), ka organizuar trajnime për personelin akademik, si një element i rëndësishëm i politikave të institucionit për ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të sigurimit të cilësisë. Trajnimet me lektorë dhe tema të zgjedhura për shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet personelit akademik mbi organizimin e klasës, vlerësimin psikosocial dhe motivimin e studentëve, si dhe teknologjitë e mësimdhënies ishin në qendër të vëmendjes. NJSBC, në ushtrim të kompetencave të saj, për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Ndryshe nga vitet e tjera, këtë vit NJSBC ka hartuar 3 pyetësorë specifikë për mësimdhënien online (distancë), mësimin online, si dhe për punën në distancë, përkatësisht drejtuar personelit akademik, studentëve, dhe stafit administrativ, gjatë periudhës së pandemisë për shkak të covid-19.</p> <p><i>(Takimi me NJSBC, Raporti)</i></p>
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/ eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton gjatë kontrollit të dokumentacionit, takimit me studentët dhe stafin, se format e mësimdhënies përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Departamenti organizon trajnime apo Workshope për të përmirësuar procesin e mësimdhënies.</p> <p><i>(Takimi me studentët, stafin, syllabuset, plani mësimor, NJSBC)</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese</p>	<p>Nga vizita në institucion është verifikuar se stafi pedagogjik i përgjigjet me seriozitet diversitetit dhe nevojave të studentëve. Pedagogët në përputhje me natyrën e programit ofrojnë metoda dhe mundësi alternative (shembuj realë, etj) në mënyrë që studenti të rrisë interesin dhe dëshirën e të nxënit. Kjo u konstatua nga GVJ gjatë takimit me studentët, të cilët pohuan se pedagogët sjellin shembuj konkrete nga punimet e tyre klinike në pacientë në ndihmë të studentëve për ta bërë lëndën sa më të qartë dhe</p>

në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	të kuptueshme për studentët. <i>(Takimi me studentët)</i>								
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.	GVJ pas takimit me stafin akademik dhe me studentët e programit, konstaton se stafi ndihmës akademik (laborantët) të cilët asistojnë studentët gjatë orëve laboratorike, <i>në disa raste nuk janë kompetent për njohuritë dhe konceptet, përsa i përket nivelit të kualifikimit të tyre. Këtë fakt GVJ ja vuri në dukje edhe drejtuesve të institucionit gjatë takimit.</i> Stafi akademik 20 PAE/ 3 PAK, 6 nga stafi PAE janë laborantë. 88% e ngarkesës mbulohet nga stafi PAE, kundrejt 12% nga stafi PAK <i>(Takimi me stafi dhe drejtuesit)</i> <i>(Cv-të e stafit akademik)</i>								
Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni ka investuar në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe kushteve të mësimdhënies. Departamenti ofron metoda pedagogjike shumë të larmishme dhe fleksibile përveç metodave të zakonshme të mësimdhënies siç janë leksionet dhe seminarët, studentët marrin pjesë në punën laboratorike, kryejnë detyra kursi dhe projekte, zhvillojnë prezantime etj. <i>(Strategjia e zhvillimit të AU)</i>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.2	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	GVJ gjatë vizitës në institucion si dhe nga informacioni i depozituar mbi planimetrinë e kampusit universitar, konstaton se procesi mësimor i programit të studimit, realizohet në hapësira të bashkëkohore, të mjaftueshme, cilësore, të pastra dhe që mirëmbahen rregullisht. <i>(Vizita në Institucion)</i> <i>(Vëzhgimi i mjediseve)</i>
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Në të gjithë universitetin është i mundur akses në rrjetin kompjuterik të shkollës, sistemet e menaxhimit dhe sekretarisë mësimore. Universiteti i pajis studentët dhe stafin e tij me emaile me bazë Google. Po ashtu studentët kanë akses të palimituar në platformën e mësimin online. Përveç menaxhimit të mësimdhënies, platforma online shërben edhe për marrjen e shënimeve, njoftimeve të ndryshme. Studenti mund të përdori këtë platformë për dorëzimin e projekteve apo detyrave të kursit. <i>(Vizita në Institucion, takimi me stafin, studentët)</i>





<p>Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>AU disponon një databazë elektronike të përditësuar me literaturën kryesore e që përdoret nga stafi dhe studentët. Literatura është bashkëkohore dhe shtohet vazhdimisht duke u vënë në shërbim të studentëve në formën e leksioneve të shkruara, në poëer point dhe në formë libri. Materialet didaktike për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjenden dhe bibliotekën e fakultetit. <i>GVJ, pasi pa literaturën në funksion të lëndëve dhe syllabuset, ku titulli më i fundit ishte i vitit 2014, sugjeron për rishikim të literaturës me tituj të viteve të fundit.</i> (Lista e librave periodikëve shkencorë në bibliotekë) (syllabuset e lëndëve)</p>			
<p>Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së, dhe takimeve në insitucion u konstatua se Google është sistemi kryesor i komunikimit dhe ndërveprimit në institucion i cili aksesohet nëpërmjet internetit. I gjithë stafi dhe studentët zhvillojnë të gjitha veprimtaritë nëpërmjet këtij sistemi qoftë proceset mësimore apo veprimtaritë e tjera administrative e kërkimore. Kjo platformë përdorej edhe për informimin e studentëve dhe zhvillimin e veprimtarive të tjera si takime, mbledhje, prezantime, diskutime etj. Në sistemin LMS çdo student ka akses dhe merr materialet mësimore të lëndëve të ndryshme, apo depoziton detyrat lëndore. (Rregullore e vëmprimtarive online)</p>			
<p>Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se për programin e studimit "Laborant i Lartë Dentar", insitucioni ka ndërtuar laboratorë të dedikuar në mënyrë që studentët të praktikojnë njohuritë e tyre. Institucioni zotëron një bazë laboratorike moderne dhe shumë funksionale dhe i shërbejnë më së miri procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës. (Vëzhgimi i ambjenteve)</p>			
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ konstaton se për programin e studimit "Laborant i Lartë Dentar", në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma online (e-learning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. (Takimi me stafin)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	



Standardi III.3

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe</p>	<p>Rektorati, Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve kanë qenë të angazhuar për mbarëvajtjen e procesit mësimor, monitorimin e regjistrimit të studentëve, menaxhimin e personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, raportimet periodike, si dhe për zgjidhjen e mjaft problematikave të evidentuara gjatë zhvillimit të procesit</p>

bashkërendojnë me njësitë kryesore/ bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.	mësimor, sezoneve të provimeve, praktikave profesionale dhe diplomimit, falë vështirësive të hasura sidomos gjatë zhvillimit të mësimimit në distancë. Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave. Praktikant më të mira, që evidentohen gjatë analizës mësimore, u bëhen të ditur të gjitha njësive bazë nëpërmjet një raporti që hartohet nga NjSBC. <i>(Rregullore e NjSBC)</i>			
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti i Stomatologjisë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies. Departamenti, me anë të një programi vjetor aktivitetesh, workshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit. <i>(Takimet me stafin)</i>			
Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.	Stafi akademik i programit të studimit profesional në “Laborant i Lartë Dentar” dhe stafi mbështetës sipas përshkrimit të Statutit të institucionit janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim. Departamenti, gjatë mbledhjeve të përmuajshme, diskuton mbi këto metoda. <i>(Takimet ne AU)</i>			
Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.	Departamenti i Stomatologjisë si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, organizojnë në mënyrë periodike workshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimit për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit të universitetit. <i>(Mobilitete të stafit dhe studentëve)</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Gjatë takimit me stafin GVJ konstatoi se personeli akademik në takimet periodike të njësive kryesore/ ndihmëse ndan eksperiencat e implementimit të metodave të reja si dhe raporton me shkrim në fund të vitit një raport që përfshihet në analizën vjetore të drejtuesit të njësisë kryesore. Gjithashtu personeli akademik dhe ndihmës akademik trajnohet dhe teston metoda të reja mësimore. Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit dhe objektivat, efektet dhe pritshmëritë prej tyre analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse. <i>(Mobilitete të stafit dhe studentëve)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.4

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.



Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimi e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion u njoh me mënyrën e zhvillimit të testimeve, ku kriteret dhe mënyra e testimi e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimmimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.</p> <p><i>(Rregullore e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultat i një mbledhje të vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar (pjesëmarrja aktive, kolokiume, detyra/ projekte, provimi përfundimtar).</p> <p><i>(Takim me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimi e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.</p>	<p>Studentët njihen me format e vlerësimit që në orët e para të mësimit. Kjo mundësohet nga ana e pedagogut të lëndës, gjatë njohjes së studentit me përmbajtjen e programit të lëndës. Syllabuset e lëndëve janë të publikuara në ndërfaqet e secilit kurs.</p> <p><i>(Syllabuset e lëndëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimi dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>AU ka hartuar edhe platformën e provimeve online. Nëpërmjet platformës së edukimit online, personeli akademik përgatit bankën e pyetjeve me shpërndarje që ruan raportet sipas kapitujve të zhvilluara. Përzgjedhja e pyetjeve bëhet në mënyrë të tillë që provimi të mundësojë një vlerësim sa më real të studentit, të eliminojë forma të ndryshme abuzimi dhe të rrisë transparencën. Mjediset ku zhvillohen provimet janë të monitoruara me personel shërbimi që ka si detyrë kryesore ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për zhvillimin normal të procesit të provimeve. Në rastet e provimeve online nëpërmjet sistemit të menaxhimit, studenti zbaton rregulloren e posaçme të provimeve. Rregulloret e Institucionit janë të pasqyruara në faqen e internetit.</p> <p><i>(Rregullore fakultetit)</i> <i>(Rregullore programi studimi)</i> <i>(Programi i studimit)</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/modulet e programit të studimit zhvillohen gjithnjë me komisione provimi me të paktën dy</p>

realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	pedagogë. Pedagogu i lëndës ka peshën kryesore në vlerësimin përfundimtar duke përfshirë dhe elementët e vlerësimit në vazhdim. Rezultatet përfundimtare të provimit janë bërë të ditur studentëve në platformën online. Detyrat, prezantimet në klasë, projektet, raste studimore, etj vlerësohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti mësimor. <i>(Rregullore programi studimi)</i>			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.	Rezultatet e provimeve dalin brenda një afati prej 7 ditësh dhe u prezantohen studentëve në mënyrë individuale nga pedagogu i modulit. Rezultatet hidhen në sistem nga sekretaria mësimore pasi studentët janë njohur me vlerësimin. Çdo student ka të drejtë për kontenstim. Pedagogët përgjegjës rishikojnë së bashku me studentin vlerësimin. <i>(Rregullore e sekretarisë)</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfitim e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënit për programet me karakter profesional.	Gjatë takimit me studentët dhe vlerësimit të lëndëve dhe syllabuseve, GVJ konstatoi se studentët në fund të vlerësimit të lëndëve kishin përfituar njohuritë e duhura duke arritur objektivat e tyre. Vlerësimet ishin në përputhje me rrezultatet e pritshme të të mësuarit. <i>(Syllabuset e lëndëve)</i> <i>(takim me studentët, pyetësori, vlerësimet e studentevë në fletat e provimeve sekretari, kalueshmëria)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.	Referuar planit mësimor 15% e kurrikulës është e përbërë nga lëndë të tipit D, kjo ndarje e lëndëve profesionale siguron njohuritë e duhura për aftësimin e përdorimin e informacionit në shërbim të aftësimit të punimeve laboratorike të ndryshme. Përveç anës profesionale, ky aftësim shërben edhe për kultivimin e punës në grup dhe diskutimet në lidhje me zgjidhjen e problematikave të ndryshme. <i>(Plani mësimor, tab 8)</i> <i>(Syllabuset e programit)</i>
Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë	Të gjitha praktikat laboratorike kryhen në laboratorët e vëna në dispozicion të këtij programi studimi të cilët janë të pajisur me

<p>njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>aparatura dhe mjete të nevojshme e bashkëkohore. Kompetencat profesionale u japin mundësi studentëve të zhvillojnë njohuritë e marra në teori dhe ti zbatojnë ato në praktikë si në laboratorët e shkollës, po ashtu edhe në praktikatat profesionale, klinikat stomatologjike.</p> <p><i>(Syllabuset e Lëndëve të programit të studimit)</i></p> <p><i>(Vizita në laborator)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik orienton studentët në përfundim të çdo lënde për implementim e njohurive të marra teorike dhe praktike duke i pajisur me materialet e shpjeguara në çdo orë mësimi.</p> <p>Kjo është një ndohmë e madhe për studentet për përgatitjen e tyre gjatë provimit përfundimtar.</p> <p><i>(Takimi me studentët)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedurën të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistria zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka një procedurë të posaçme për provimin final, ose mbrojtjen e diplomës, e përshkruar edhe në rregulloren e institucionit dhe e bërë publike dhe e aksesueshme në faqen e internetit. Ai mban regjistria zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p> <p><i>(Rregullorë e AU)</i></p> <p><i>(Takimi me studentët)</i></p> <p><i>(Takimi me sekretarinë)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Departamenti dhe stafi akademik vënë dispozicion të studentëve dhe publikon dhe në faqen online një program mbështetës për provimin përfundimtar, informacione dhe udhëzime. Pedagogët janë të disponueshëm për ofrimin e konsultimeve për studentët, në raste të caktuara gjatë përgatitjes së tyre për provimin përfundimtar. Provimi përfundimtar zhvillohet konform rregullores.</p> <p><i>(Takimi me studentët)</i></p> <p><i>(Rregullore diplomimi)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
--	-----------------------	------------------------------	--	------------------------------

IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se procesi i rekrutimit, të dhënat të kandidatëve aplikues si dhe shpallja e fituesve realizohej me rigorozitet e transparencë të plotë. Vendet vakante janë në përputhje me planin mësimor. Nevoja për personel akademik bëhej publike duke specifikuar specialitetin e duhur dhe kriteret që duhet të plotësojë çdo kandidat. Dosjet e kandidateve shqyrtoheshin nga komisioni i vlerësimit dhe rekrutimit. Pasi komisioni bënte vlerësimin e personelit akademik, zyra e burimeve njerëzore angazhohej në hartimin e kontratës mes palëve. Stafi akademik është i kualifikuar me tituj e grada shkencore, me eksperiencë disa vjeçare në mësimdhënie si dhe me kifikime të vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit. Përzgjedhja realizohet konform rregullores. Vendet vakante shpallen në uebsite të Universitetit. Komisioni i Vlerësimit realizon përzgjedhjen e stafit akademik me kohë të plotë ose të pjeshme në bazë të kërkesës që kalon nga Përgjegjesi i Departamentit, tek Dekani, Rektori. Çdo vit rishikohen nevojat për plotësimin apo rishikimin e strukturave të stafit akademik dhe ngarkesës së tyre mësimore dhe shkencore. Institucioni disponon një procedura dhe kriteret të përcaktuara për punësimin e personelit akademik.</p> <p><i>(Procedura e rekrutimit të stafit)</i> <i>(Rregullore e përgjithshme e AU)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Përpara fillimit të vitit akademik hartohet plani për angazhimin dhe kompletimin e stafit akademik në programin e studimit "Laborant i Lartë Dentar".</p> <p>Pasi përcaktohen pedagogët për secilën lëndë informohen për ngarkesën e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Personi përgjegjës për organizimin e planit paraqet tek Dekani angazhimin e anëtarëve të personelit akademik sipas semestrave për secilin vit.</p> <p>Tutoriati dhe vëzhguesit e praktikës bëjnë koordinimin e punës midis pedagogëve, sekretarisë dhe studentëve, ndërsa pedagogët e praktikave bashkërendojnë aktivitetin praktik për studentët.</p> <p><i>(Takimi me stafin dhe studentët)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional</p>	<p>Drejtimi dhe organizimi, angazhimi i stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, njësitë mbështëse, sekretaria, tutoriati, përfshirja e aktorëve bashkëpunues dhe ndihmues mundësojnë në plotësimin e objektivave të studimit për studentët e programit "Laborant i Lartë Dentar".</p>

dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<i>(Takimi me stafin dhe studentët)</i> <i>(Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore)</i>			
Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Departamentet mbështeten financiarisht për organizimin e aktiviteteve të ndryshme shkencore si organizimin e konferencave shkencore, leksione të hapura me lektorë të huaj apo pjesë e stafit, trajnime, workshope, publikime etj. GVJ konstaton se institucioni organizon trajnime pedagogjike, profesionale, me përfshirjen e stafit dhe të studentëve. Në takimin me stafin akademik dhe studentët rezultojnë se AU në kuadër të procesit mësimor zbaton metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe testimit të njohurive, përdor module specifike për të mbështetur metodat inovative të mësimdhënies si krijimi i klasave virte, shkëmbimi i materialeve me studentët, ndërveprimi dhe komunikimi me studentët, përditësimi i ndërfaqes personale të pedagogut. GVJ konstaton se institucioni ka angazhim maksimal të burimeve njerëzore në përbushje të objektivave të këtij programi studimi. <i>(Tabelat RVB)</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në RVB si dhe vizitën në institucion, rezultojnë se AU vë në dispozicion ambiente të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhënies duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe specifikën e programit të studimit. Auditorët, laboratorët, dhe mjediset ndërmjetëse ishin të gjitha funksionale. <i>(RVB)</i> <i>(Vizita në institucion)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të	Nga vizita në Institucion u konstatua mbulim i plotë i godinës së Universitetit me rrjet interneti wireless në dispozicion të punonjësve dhe studentëve. Sallat e laboratorëve të informatikës, bibliotekës, sallat e laboratorëve të pajisura me kompjutera dhe çdo sallë mësimore në auditor e pajisur me kompjuter, videoprojektor, sisteme kondicionimi. Molazhet dhe manikinat ndihmojnë studentët në procesin mësimor dhe përvetësimin e njohurive profesionale.

Palumbo

Albi



mësimdhënies-mësimnxënies.	<i>(Vizita në institucion)</i>			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Laboratorët që studentët ushtronin aktivitetet e tyre praktike ishin pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër, për kryerjen e orëve laboratorike. Laboratorët, janë të disponueshëm për studentët gjatë orëve të mësimin, për përgatitjen e detyrave të kursit, punimeve laboratorike praktike apo studimeve të tjera nga ana e tyre, nën kujdesin e laborantëve. Posterat i përgjigjeshin nevojave të studentëve sipas programit tyre të studimit. <i>(Vizita në institucion)</i> <i>(Takimi me studentët)</i>			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	GVJ pa nga afër laboratorin e Informatikës të kompletuar me pajisje të fundit bashkëkohore që shërbente dhe vihej në dispozicion të studentëve si për zhvillimin e lëndëve si Informatikë, Biostatistikë, apo edhe për zhvillimin e detyrave të kursit për studentët, vlerësimeve të testeve në formë kuicash, mësimin dhe marrjen e informacioneve të ndryshme nga vetë studentët. <i>(Vizita në institucion, mbikqyrja e ambjenteve)</i> <i>(Takimi me studentët)</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.	Referuar RVB si dhe gjetjeve gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se për programin mësimor "Laborant i Lartë Dentar" mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe njëkohësisht të posaçme si për zhvillimin e leksioneve e seminareve dhe laboratorëve të programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi laboratorin ku kryheshin të gjitha praktikatat nga studentët. <i>(Vizita në institucion, mbikqyrja e ambjenteve)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij


Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon	GVJ pa nga afër bibliotekën mësimore. Nga biseda me studentët dhe stafin kjo bibliotekë përmbushte kërkesat e tyre për literaturë të përshtatshme në lidhje me programin e studimit 2 vjeçar "Laborant i Lartë Dentar". Studentët kishin mundësinë e përdorimit të kompjuterave për aksesimin e bibliotekës online gjithashtu. Studentët regjistrohen në kartelat që iu lejon të marrin librat në ambjentet

<p>kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>e sallave të studimit brenda universitetit. Orari i shërimit të bibliotekës ishte në përputhje me orarin mësimor të studentëve, duke krijuar mundësinë e shfrytëzimit nga studentët në cdo kohë. <i>(Vizita në bibliotekë, takimi me punonjësen e bibliotekës)</i> <i>(Takimi me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Literatura mbulon nevojat e studentëve për lëndët bazë, lëndët profesionale në gjuhën shqipe por edhe në gjuhë të huaja. Literatura është bashkëkohore dhe shtohet vazhdimisht duke u vënë në shërbim të studentëve. Materialet didaktike për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjenden dhe bibliotekën e fakultetit. Kjo bibliotekë ka një total prej 2871 librash që ndahen sipas degëve, libra studimorë, akademikë, artistike, fjalorë, si dhe revista të ndryshme shkencore, literaturë e huaj, kumtesa konferencash dhe artikuj të ndryshëm gazetash të Universitetit. Në këtë bibliotekë gjenden të skeduar 1121 tituj nga të cilat një pjesë i përket programit akademik të fushës Mjekësore: 335 tituj. <i>(Vizita në bibliotekë, takimi me punonjësen e bibliotekës)</i> <i>(Takimi me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve janë vënë një sërë librarish online, të cilat janë të aksesueshme nën kujdesin e punonjëses së bibliotekës në qendrën e internetit. Libraritë online të këshilluara janë sipas fushave përkatëse të studimit. Pedagogët çdo vit kërkojnë botime të reja për të përditësuar fondin ekzistues të literaturës përkatëse të programit të studimit “Laborant i Lartë Dentar”. Aksesi nga studentët është free si për librat në bibliotekë ashtu edhe për leximin online. Biblioteka ishte e pajisur me sallë leximi. Secili person posedon kartelën e tij të bibliotekës. Institucioni akordon çdo vit një fond të përshtatshëm për literaturë bazuar në kërkesat e departamentit. GVJ iu vu në dispozicion edhe lista e teksteve periodike në Bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit të studimit. <i>(Vizita në bibliotekë, takimi me punonjësen e bibliotekës)</i> <i>(Takimi me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t’u lehtësojnë dhe garantojnë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Mbështetja dhe bashkëpunimi me klinika stomatologjike, aftësimi praktik i tyre pranë specialistëve të fushës ka ndihmuar dhe mbështetur studentët për thellimin e dijeve dhe fitimin e kompetencave profesionale. Institucionet partnere kanë vënë gjithë burimet e tyre njerëzore, logjistike, mjetet dhe pajisjet në funksion të studentëve dhe i janë përgjigjur nevojave të tyre bazuar në programin e studimit “Laborant i Lartë Dentar”. <i>(Takimi me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për</p>	<p>GVJ konstaton se ka buxhet të pavarur dhe harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e tij për cikël të plotë studimi. Buxheti vjetor miratohet nga Bordi i Administrimit të Universitetit pasi kalon nëpër disa</p>






<p>mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>faza diskutimesh ku paraqiten nevojat dhe shqyrtohen mundësitë. Fillimisht nevojat paraqiten duke plotësuar formularë të standartizuar të cilat dërgohen në njësitë kryesore, njësitë bazë dhe njësitë e tjera. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga ky informacion ai mësoi që burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhej nga Zyra e Financave bazuar në zërat e miratuara në buxhet.</p> <p><i>(Strategjia e zhvillimit.)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve të AU.</p> <p>Çdo fund viti akademik hartohen pasqyrat financiare, ku përcaktohet gjëndja financiare dhe realizimi i Projekt - Buxhetit të AU. Institucioni kryen çdo vit auditimin edhe pse, duke qënë një institucion jo publik trajtohet si biznes me të drejtat dhe detyrimet ndaj punonjësve, studentëve dhe shtetit.</p> <p><i>(Strategjia e zhvillimit.)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



<p>Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e proçedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, proçedura e kritere të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për</p>	<p>Vlerësimi</p> <p>GVJ konstatoi se UA ka përcaktuar shumë qartë kriteret e pranimit të studentëve për programet me karakter profesional 2-vjeçar. Kriteri i parë pranimit në “Albanian University” është përfundimi me sukses i arsimit të mesëm të lartë. Për programin profesional 2 vjeçar “Laborant i Lartë Dentar”, nuk është kriter mesatarja. Aplikimi kryhet në Portalin U-Albania për degët që maturanti kërkon në “Albanian University”, sipas përcaktimeve të udhëzimeve përkatëse. Udhëzimet e AU të paraqitura mbi proçesin mësimor, mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe zhvillimit të provimeve të moduleve dhe diplomës, vihen në dispozicion të stafit</p>

<p>të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>akademik dhe studentëve. Të gjithë gëzojnë të drejta të barabarta kandidatë dhe studentë. Manet janë në dispozicion të studentëve edhe online. <i>(Vizita në sekretarinë e AU);</i> <i>(Faqja e uebsite e AU)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.</p>	<p>AU në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit vepron duke nxjerë udhëzime të reja Institucionale në përgjigje të legjislacionit në fuqi dhe bën me dije çdo vit kriteret e pranimit të maturantëve kandidatë për programet e studimit me karakter profesional. Këto kriteret afishohen edhe në uebsite të AU në mënyrë që publiku dhe të interesuarit të marrin informacionin e duhur mbi këto kërkesa. <i>(Vizita në sekretarinë e AU)</i> <i>(Faqja e uebsite e AU)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.</p>	<p>Rregulloret përkatëse mbi procesin mësimor, syllabuset e moduleve,veprimtaritë teoriko- praktike, format e vlerësimit, pikëzimin për çdo modul, kreditet e lëndëve, organizimin e praktikave laboratorike si në ambientet e AU po ashtu edhe jashtë saj, bëhen të ditura për studentët nga pedagogët e moduleve që në fillim të lëndëve. Studentët referuan se ishin plotësisht të informuar. <i>(Takimi me studentët, takimi me stafin)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit të studimit 2 vjeçar në "Laborant i Lartë Dentar" në AU u konstatua se ata kishin të qartë strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të tyre të studimit. Zyrat e koordinimit dhe mbështjes studentore, Zyra e Karrierës dhe Alumnit, kanë ndihmuar studentë të punësohen gjatë dhe pas përfundimit të studimeve. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët (Tutoriat & Mentorimi) orienton, inkurajon dhe mbështet studentët pranë "Albanian University" për zhvillimin e tyre personal dhe profesional nëpërmjet aktivizimit në programe jashtë mësimore me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Mbështet studentët në përgatitjen e tyre më të mirë për punësim dhe inkurajon zhvillimin e karrierës së tyre në fusha të caktuara studimi. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët ofron shërbime për studentët e "Albanian University", të cilët kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, me qëllim promovimin e studentëve të "Albanian University" dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. Jep asistencë për realizimin e instrumenteve të kërkimit të një vendi pune (përgatitja e</p>

	<p>CV_së, letrës së motivimit, intervistës së punës etj.). Organizon pyetësorë për studentët me qëllim vlerësimin e interesave, vlerave dhe aftësive profesionale. Organizon Trajnime/ Work shop_e për zhvillimin e qëndrimeve dhe aftësive të të diplomuarve në tregun e punës. Informon dhe promovon ofertat e intershipeve, praktikave profesionale, vendeve të punës, bursave, konkurseve, shkollave verore etj. Mundëson lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike, organizata, kompani, ndërmarrje profesionale të tregut të punës. Organizon selektimin e studentëve për rekrutimin e tyre pranë institucioneve partnere. Mban lidhje të vazhdueshme dhe aktive me kompanitë brenda dhe jashtë vendit si dhe vlerëson/ analizon kërkesat e tyre të ofertave të punësimit; Përgatit guida dhe fletpalosje për orientimin e studentëve, Është përgjegjëse për organizimin e Panairit të karrierës. Mban marrëdhënie të vazhdueshme me shoqatat apo organizime të tjera të Alumnit dhe i mbështet ato në funksionimin e tyre.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumnit Zyra e Karrierës dhe Alumnit shpërndan për studentët e diplomuar informacione mbi ofertat e tregut të punës, mundësinë e praktikave, intershipeve, kualifikimeve etj, organizon takime mes studentëve të diplomuar me studentët akt me qëllim shkëmbimin e eksperiencave të punësimit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta. Zyra e Karrierës dhe Alumnit i ndihmon ish-studentët përmes dhënies së referencave për studime dhe punësim. Kujdeset për krijimin e një database statistikash të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve në “Albanian University”.</p> <p><i>(Takimi me studentët, takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Zyrës së mbështetjes studentore)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Dokumentacionet e AU dhe faqja e uebsite e universitetit përshkruajnë për secilin program të dhëna të sakta mbi modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese.</p> <p>Programi studimit 2 vjeçar në "Laborant i Lartë Dentar" në AU ka formimin praktik të studentëve, bazuar në kurrikulën me peshën kryesore të orientuar drejt formimit praktik-klinik të studentit.</p> <p>Sallat, laboratorët mundësojnë plotësisht realizimin e këtij programi.</p> <p><i>(Takimi me studentët, takimi me stafin)</i> <i>(Faqja e uebsite e AU)</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Studentët janë të organizuar në këshilla studentorë si dhe kanë marrëdhënie të ngushta me stafin akademik, nëpërmjet sistemit të mentorimit dhe tutoriatit. Tutoriati funksionon për çdo vit akademik ku secili pedagog përgjegjës mban lidhje të ngushta me përfaqësuesit e studentëve në lidhje me programin e studimit "Laborant i Lartë Dentar". Informacioni shpërndahet tek të gjithë studentët njëkohësisht dhe në mënyrë të kontrolluar. Në sistemin online në distancë, rifreskohen informacionet të cilat aksesohen në kohë reale nga gjithë studentët.</p> <p><i>(Takimi me studentët)</i></p>



	<i>(Faqja e uebsite e AU)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Sekretaria mësimore e AU është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përditësimin periodik të të dhënave të studentëve nga regjistrimi i maturanëve fitues nga portali U-Albania e deri në diplomim e studentëve të AU. Stafi akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ si dhe studentët kanë adresën e tyre të e-mail-it, të cilën mund ta aksesojë në çdo kohë brenda dhe jashtë Universitetit. Përmes sistemit online në faqen e AU https://albanianuniversity.edu.al/, studentët aksesojnë të dhënat personale, rezultatet e provimeve sipas semestrave apo viteve akademike, si dhe të dhëna të tjera didaktike. Zyra e Karrierës dhe Alumnit administron të dhëna të studentëve të diplomuar dhe plotëson qëllimin e saj për ti ndihmuar studentët të integrohen sa më shpejt në tregun e punës.</p> <p><i>(Vizita në sekretarinë dhe Zyrën e Karrierës dhe Alumnit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë mbyqyrjes së dokumentacionit u konstatua dokumentacion i rregullt në lidhje me strukturën e Senatit/ Rektori, Zv. Rektori KSH, Zv. Rektori për procesin mësimor, Dekanët, Përgjegjësit e Departamenteve, Stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm sipas Fakulteteve dhe Programeve të studimit, Stafin Administrativ, Njësitë pranë rektoratit, Njësitë ndihmëse dhe Shërbimi, Njësitë Administrative.</p> <p><i>(Vizita në sekretarinë e AU)</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Të gjitha veprimtaritë siguroheshin nga Sistemi i brendshëm i menaxhimit i cili funksiononte më së miri duke administruar dosjet përkatëse me dokumenta origjinale dhe online. Informacionet që lidhen me aktivitetin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe atij ndihmës akademik ruhen në Departament dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ndërsa dokumentacionet që i përkasin studentëve administrohen nga sekretaria. Dosjet ishin të plota, me të gjithë informacionin dhe të dhënat personale të personelit: CV, ID, Diplomat e kifikimit, librezat shëndetsore, raporti mjekoligjor, librezat e punës, kontrata e angazhimit, etj. Në mënyrë periodike bëhet azhurnimi i CV-ve kur merren titujt me të lartë akademike, kryen trajnime të edukimit në vazhdim, botohen apo publikohen artikuj e referime. Në vizitën e kryer në sekretari dosjet e studentëve ishin të plota, të kompletuara me të gjitha dokumentacionet e vlefshme të kërkuara.</p> <p><i>(Vizita në Zyrën e burimeve njerëzore e AU)</i> <i>(Vizita në sekretarinë e AU)</i></p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sekretaria online dhe Biblioteka online ndihmojnë në shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Sistemi online siguron akses të veçantë për secilën kategori si për sekretarinë, stafin dhe studentët. Secili grup kishte hapësirën e vet në këtë sistem ku mund të logohej me të dhënat personale dhe të marrë informacionin për të cilin ka mundësi të sigurojë akses të dedikuar në informacione dhe dokumente si për personelin, ashtu edhe për studentët e programit të studimit. Ky sistem integron platformën e edukimit në distancë, nëpërmjet së cilës pedagogët dhe studentët mund të komunikojnë në grup ose individisht, të përcjellin materialet e modulit, të kontrollojnë projektet apo të diskutojnë virtisht mbi modulën mësimor. Sistemi monitorohet në kohë reale nga IT e Universitetit të cilët përgjigjeshin për çdo problematikë dhe vazhdimisht kryenin raportime lidhur me ecurinë e sistemit.</p> <p><i>(Takimi me stafin dhe studentët e AU)</i> <i>(Faqja e uebsite e AU)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Rregjistrat dhe evidencat paraqesin të dhëna mbi aktivitetin e procesit mësimor të kryer, ndërsa dosjet e aktiviteteve akademike dhe administrative japin të dhëna në një kohë reale mbi organet drejtuese, titullarët. Faqja e uebit rifreskohet periodikisht për të mundësuar të rehat e fundit mbi aktivitetet e Universitetit, kërkimin shkencor, informacione të rëndësishme për stafin, studentët dhe personat e interesuar.</p> <p><i>(Vizita në Zyrën e burimeve njerëzore e AU)</i> <i>(Vizita në sekretarinë e AU)</i> <i>(Faqja e uebsite e AU)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në website të Universitetit https://albanianuniversity.edu.al/ i cili funksionon prej 10 vitesh në 3 gjuhë, në gjuhën vendase shqip, gjuhë të huaj anglisht dhe italisht. Uebsite paraqet të dhëna të përgjithshme rreth Universitetit, Historikut të tij, Misionit dhe Vlerave, Strukturës dhe Organizimit Institucional, Akteve Normative, Statusi dhe Rregulloreve Institucionale, Të dhëna mbi Stafin, Bordin e Administrimit, Stafin Administrativ, Strategjinë e zhvillimit Institucional, Politikat e privatësisë në AU. Aty mund të gjejmë të dhëna mbi Fakultetet, Programet e studimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi të orientohen mbi Kalendarin Akademik, Oraret mësimore, Sekretarinë, Bursat, Zyrat e koordinimit dhe mbështjes studentore, Zyra e Karrierës dhe Alumnit, Këshilli studentor, Klubet studentore, Kriteret e Pranimit, Mane dhe Udhëzime të Universitetit. Vend të rëndësishëm zë Kërkimi shkencor dhe Shërbimet.</p> <p><i>(Faqja e uebsite e AU)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore, zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundësuar ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Çdo student që paraqet kërkesë për transferim për largim apo kalim në AU, ka të drejtë ta realizojë këtë në bazë të rregullores së AU dhe legjislacionit në fuqi të MASR. Kuotat për transferimet përcaktohen çdo vit akademik dhe miratohen në Senat. Çdo student që paraqet kërkesë për largim dhe transferim në një institucion tjetër të arsimit të lartë duhet të çrregjistrohet më parë nga AU dhe të kryejë procedurat e duhura për këtë qëllim në njësitë përkatëse. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen dhe specifikohen kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të krediteve. Dekani i Fakultetit ngrekomisionin e vlerësimit të ekuivalentimit</p> <p><i>(Statuti i AU)</i> <i>(Rregullore e AU)</i> <i>(Rregullore e programit të studimit)</i> <i>(Takimi me dekanin, studentët)</i> <i>(RVB)</i> <i>(Vendim Senati mbi Kriteret e pranimit në programin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Këto politika dhe procedura shprehen në planin strategjik të universitetit, Statutin e Universitetit, Rregulloren e Universitetit dhe në rregulloren e fakultetit. Në rregulloren e programit shprehet qartë garantimi i barazisë dhe i të drejtave të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e universitetit. Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësia para çdo fillim viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet pranë ambjenteve të Universitetit organizohet fushata e informimit. Staf i ngarkuar për informim pret dhe sqaron të interesuarit me informacionin e nevojshëm për pranim.</p> <p><i>(Statuti i AU)</i> <i>(Rregullore e AU)</i> <i>(Rregullore e programit të studimit)</i> <i>(Takimi me dekanin, studentët)</i> <i>(RVB)</i> <i>(Vendim Senati mbi Kriteret e pranimit në programin e studimit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti</p>	<p>Para fillimit të vitit akademik institucioni organizon fushatën e informimit për të gjitha programet e studimit. Në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit stafi i ngarkuar për informim pret dhe jep gjithë informacionin e nevojshëm për pranim. Çdo vit akademik që në muajin shkurt në portalin U-Albania hidhen të gjitha</p>

<p>akademik, udhëzohet publikon dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>kriteret e pranimit për studentët që do të aplikojnë në fund të muajit korrik. Po ashtu këto kritere pasqyrohen në Uebsite e Universitetit dhe në rrjete e tjera sociale që Universiteti posedon.</p> <p>Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj të cilët regjistrohen si çdo maturant nëpërmjet sistemit U-albania në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>(Statuti i AU)</i> <i>(Rregullore e AU)</i> <i>(Rregullore e programit të studimit)</i> <i>(Takimi me dekanin, studentët)</i> <i>(RVB)</i> <i>(Vendim Senati mbi Kriteret e pranimit në programin e studimit)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>AU vë në dispozicion gjithë dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve. Sekretaria posedon gjithë dokumentacionin e plotë dhe të hollësishëm mbi numrin e krediteve të fituara të studentëve nga një vit akademik në tjetrin, ekuivalencën e krediteve të marra nga një institucion tjetër. Fletët e provimeve të vlerësimeve në proces verbalet të datuara dhe të firmosura nga të gjithë aktorët, pedagogët, dekani, gjenden në kasafortën e sekretarisë ku ruhen me kujdes. Të dhënat mbi lëndët përbërëse, modulet, vlerësimet përfundimtare sipas viteve të studimit hidhen në regjistra në formë mane por edhe në sistemin online.</p> <p><i>(Takimi me sekretarinë, sistemi online)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Pedagogët e moduleve që në fillim të lëndës informojnë studentët për emërtimin e modulit, objektivat, përmbajtjen e lëndës, procedurat e vlerësimit sipas natyrës së lëndës teorike apo praktikë, peshës që zë në program, numrit të krediteve. Konsultimet mbi përgatitjet e provimeve të lëndëve dhe diplomimit ndihmojnë studentët në një orientim të drejtë dhe përgatitje specifike për çdo modul dhe diplomë në fund të studimeve.</p> <p><i>(Takimi me stafin, studentët, rregullore e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimit)</i></p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm takime dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Referuar materialeve që AU disponon si: manifesti i AU, fletëpalosje, vizita të pedagogëve në shkollat e mesme, promocioni, takimet e hapura, reklamat televizive tregojnë qartazi se AU realizon informim për maturantët dhe të interesuarit për AU dhe programet e studimit që ofron. Numri i madh i regjistrimeve tregon për një interesim të maturantëve për këtë Universitet.</p> <p><i>(Manifesti, uebsite i AU, Takimi me stafin, studentët)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi V.2
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit

Pejudhë

Uly

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.	Kalendari akademik ofrohet për studentët dhe pedagogët në fillim të vitit akademik. Ai hartohet në bazë të udhëzimeve të publikuara nga MASR. Përgjegjësi i programit të studimit informon për rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës. Tutoriati koordinon informacionin me senatorët e grupeve të studentëve sipas viteve. <i>(Rregullore e programit të studimit.)</i>			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Gjatë javës së parë të vitit akademik, institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave studentët informohen mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Tutoriati vë në dispozicion të studentëve strukturën e ndarjes së praktikave dhe organizon punën për mbarëvajtjen e tyre me pedagogët përgjegjës dhe partnerët mbështetës. Këta të fundit shpesh herë janë urë lidhëse midis punëdhënësve të ardhshëm dhe të diplomuarve të cilët janë gati për tregun e punës. <i>(Struktura e ndarjes së praktikave)</i> <i>(Syllabuset)</i>			
Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët në bashkëpunim me tutoriatin dhe sekretarinë marrin informacion të plotë, të saktë, të rifreskuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Sistemet online ndihmojnë në shpërndarjen e informacionit në kohë reale. <i>(Takimi me stafin, studentët, sekretaria online)</i>			
Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance	Nëpërmjet faqes zyrtare të Albania University, studentët mund të përdorin sistemin online në çdo kohë dhe nga çdo pajisje elektronike të lidhur me internet dhe të aksesojnë të dhënat e tyre individuale dhe ato institucionale. <i>(Takimi me stafin, studentët, sekretaria online)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profillin e studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e	Nga verifikimi në sekretarinë sekretarinë mësimore u konstatua se në regjistrin e të diplomuarve, regjistrohen të diplomuarit në vite sipas

studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	programit të studimit në "Laborant i Lartë Dentar". (Takimi në sekretarinë, NjSBC)			
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni mirëmban regjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët në vite, studentë të regjistruar për herë të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera. Në regjister hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin. Raporti vjetor i NjSBC përmbledh të dhëna të rëndësishme për çdo program studimi në lidhje me këtë kriter. (Takimi në sekretarinë, NjSBC)			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin event të tyre.	Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (proçesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën online. Të dhënat për punësim ruhen në Zyren e Karrierës, Koordinimit dhe mbështetjes ndaj Studentëve. (Faqja e uebsite e AU) (Vizita në IAL)			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me studentët. Sistemi i menaxhimit të tyre është i sigurtë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar në varësi të detyrës. (Sekretaria, Dega Mësimore, Tutoriati Akademik).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstatoi se institucioni harton raportin vjetor për të gjitha njësitë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sygjerohen masa për përmirësim. Zyra e Karrierës, Koordinimit dhe mbështetjes ndaj Studentëve ruan të dhëna për punësimin e studentëve, këto të dhëna merren dhe përpunohen në raportin analitik. (Takimi në sekretarinë, NjSBC)			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e	Në statutin dhe rregulloren e AU, parashikohet përfshirja e studentëve në hallkat vendimmarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave ligjore të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Këshilli Studentor i

Peludhe

Urey

<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>“Albanian University” (KSUU) është një organizim i pavarur i studentëve i cili nuk zhvillon veprimtari politike dhe ekonomike. Ky këshill promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. Këshilli Studentor i “Albanian University” shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. (Takimi me studentët, NJSBC)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët përfaqësohen në Senatin Studentor, me një senator për çdo kurs, si dhe në komisione të tjera me përfaqësues studentësh si NJSBC, komisioni i kurrikulave, grupi i punës GVB, komisioni i kërkimit shkencor, senati akademik. Kjo u konstatua dhe në dokumentacion e vënë në dispozicion ku Senati, NJSBC, grupi i punës RVB e kishin prezent përfaqësuesin studentor. Studentët gëzojnë të drejtat e tyre që respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. (Takimi me studentët)</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Institucioni në vazhdimësi është i hapur dhe me vëmendje të veçantë për propozimet e studentëve. Këtu ka një rol të rëndësishëm alumini ku AU mbante kontakte të vazhdueshme me studentët që vazhdojnë cikle të tjera jashtë vendit apo që kanë aplikuar për njohje diplome dhe këta studentë jepnin opinionet e tyre për përmirësimin e kurrikulës konform programeve të ngjashme në vendet perëndimore. (Takimi me studentët)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në bazë të anketimeve të përvitshme dhe mbledhjeve të tutoriatit për këtë program studimi mblidhen opinione që reflektohen në departament nga ku lindin sugjerimet për përmirësimin e kurrikulës. (Takimi me studentët)</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Secili student ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit, ta rishikojë dhe ankimojë atë. Lihet një afat kohor prej 7 ditësh nga deklarimi paraprak i notës në sistemin online, ku priten ankimimet pranë sekretarisë mësimore apo pedagogut tutor duke caktuar me pas një datë kur në prezencën e pedagogeve të komisionit të provimit dhe studentit rishikohet teza. Për të qënë transparent gjatë korigjimit, provimet kryhen me sistemin e sekretimit dhe pedagogu i korigjon provimet pa e ditur se kujt i përket teza e provimit. Për çdo problem lidhur me barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së Procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, studenti ka të drejtë të shprehë</p>

Peshkalla

Ally

	mendimin e tij të lirë në mënyrë anonime gjatë pyetësorëve të herëpashershëm që AU organizon. (Rregullore e Senatit studentor) (Rregullore e AU) (Takimi me stafin, Takimi me studentët)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni ka procedurë e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedurë e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët ka për mision të orientojë, inkurajojë dhe të mbështesë studentët pranë “Albanian University” për zhvillimin e tyre personal dhe profesional nëpërmjet aktivizimit në programe jashtë mësimore me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Objektivi kryesor i kësaj zyre është të mbështesë studentët në përgatitjen e tyre më të mirë për punësim dhe të shërbejë në inkurajimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre në fusha të caktuara studimi.</p> <p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët ofron shërbime për studentët e “Albanian University”, të cilët kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, me qëllim promovimin e studentëve të “Albanian University” dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit.</p> <p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit ka përgjegjësinë institucionale të informimit dhe të orientimit të studentëve dhe të çdo personi tjetër të interesuar për veprimtarinë e Fakulteteve të Universitetit; Informacionet bazë studentët i marrin nga faqja zyrtare e institucionit e cila është vazhdimisht e përditësuar si dhe nga zyrat përkatëse.</p> <p>Në AU Zyra e Informimit dhe Këshillimit të Karrierës mbledhë, përpunon dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve në programin e studimit "Laborant i Lartë Dentar". (Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët)</p>
<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që</p>	<p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturanëve mbi programet e studimit të ofruara në bashkëpunim të ngushtë me departamentin, dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit.</p> <p>Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve.</p>

Peludlo

Alley

kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	(Zyra e Karrierës dhe Alumnit)			
Kriteri 3. Përmes zyrës/ njësisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët. Nga takimi me studentët, doli që ndihma e pedagogëve nëpërmjet konsultimeve dhe materialeve ndihmëse ishte shumë efektive. (Zyra e Karrierës dhe Alumnit) (Takimi me studentët)			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.	Albanian University ka realizuar një statistikë mbi efektshmërinë e diplomës së Albanian University në tregun e punës në Shqipëri e më gjerë dhe kohën që zakonisht merr një diplomë e Albanian University për t'u punësuar në tregun aktual të punës, duke u bazuar në të dhëna faktike. Për këtë qëllim Zyra e Karrierës dhe Alumnit ka grumbulluar të dhëna nga burime të ndryshme, me qëllim pasjen e një informacioni të saktë, të besueshëm, më konkretisht ka mbledhur të dhëna nga: 1. Departamentet; 2. Agjencitë e punësimit; 3. Urdhrrat përkatës për profesionet e lira; 4. Pyetësori i krijuar për studentët e diplomuar në vitin 2020. (Zyra e Karrierës dhe Alumnit)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të Programit të studimit me karakter profesional “Laborant i Lartë Dentar” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Privat “Albanian University”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e pranimit.
2. Interesimi dhe rritja e numrit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi.
3. Sistemi i menaxhimit të informacionit është i sigurtë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga studentët.
4. Universiteti zotëron disa struktura klinike dentare të cilat vihen në dispozicion të programit të studimit me karakter profesional “Laborant i Lartë Dentar”.
5. Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Stomatologjisë organizon trajnime apo workshope për të përmirësuar procesin e mësimdhënies.

Pika të dobëta :

1. Syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese por duhet të rishikohen temat e disa lëndëve profesionale, të cilat duhet të jenë të përshtatura për laborantët dentar. **(Standardi II.2, kriteri 3)**
2. Staf i ndihmës akademik (laborantët) të cilët asistojnë studentët gjatë orëve laboratorike, në disa raste nuk janë kompetent për njohuritë dhe konceptet, përsa i përket nivelit të kualifikimit të tyre. **(Standardi III.1, kriteri 4)**
3. Literatura në funksion të lëndëve dhe syllabuset, ku titulli më i fundit ishte i vitit 2014 **(Standardi III.2, kriteri 3)**

Rekomandime:

1. Syllabuset duhet të rishikohen temat e disa lëndëve profesionale, të cilat duhet të jenë të përshtatura për laborantët dentar, gjithashtu lëndet profesionale të kenë me shumë orë praktike.
2. Literatura e lëndëve profesionale të përditësohet dhe të jetë e viteve të fundit.
3. Rekomandojmë që për këtë program studimi të shikohet mundësia që të bëhet me 3 vite akademike.

Conclusions of the Evaluation on the professional program in "Senior Dental Laboratory Technician" in the Private University "Albanian University"

Strengths and affirmations:



1. The institution is providing full and detailed information about the accession criteria.
2. Interest and increase in the number of students enrolled in this study program.
3. The information management system is safe and easily accessible by students.
4. The university owns several clinical dental facilities that are made available to the vocational study program "Dental Laboratory Technician".
5. The Faculty of Medical Sciences and the Department of Dentistry organizes trainings and workshops to improve the teaching process.

Weak points:

1. The syllabuses of formative modules and trainings are informative but the themes of certain professional subjects should be reviewed and must be adapted for dental technicians. **(Standard II.2, criteria 3)**
2. The academic assistants' staff (technicians) who assist students during laboratory hours, in some cases have limited knowledge and concepts, regarding their level of qualification. **(Standard III.1, criteria 4)**
3. Literature in the function of subjects and syllables, where the most recent title was 2014 **(Standard III.2, criteria 3)**

Recommendations:

1. Syllabuses should be reviewed and the themes of certain professional subjects must be adapted for dental technicians. We also recommend having more practical working hours during professional classes.
2. The literature of professional subjects should be updated to the recent years.
3. We recommend this study program to be carried out within three academic years.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X